



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
GRAMSH

Nr. 1152 / prot  
h

Gramsh më 30 /03/2020

**V E N D I M**

Nr. 27 ,date 26 / 03/2020

**Mbi miratimin e fondeve shtesë për kontratën me sipërmarrje për shërbimin e pastrimit, evadimit dhe transportit të mbeturinave për qytetin e Gramshit, si rezultat i përhapjes së COVID-19.**

Këshilli i bashkisë Gramsh në mbledhjen e tij të dates 26.03.2020, mbi bazë të relacionit të paraqitur nga drejtoria e shërbimeve dhe ajo financës “Mbi miratimin e fondeve shtesë për kontratën me sipërmarrje për shërbimin e pastrimit, evadimit dhe transportit të mbeturinave për qytetin e Gramshit, si rezultat i përhapjes së COVID-19”, në mbështetje të Aktit Normativ nr.5 datë 17.03.2020 “Për një shtesë në Aktin Normativ Nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”, të kontratës nr.2040, datë 01.09.2015, “Për mirëmbajtjen me sipërmarrje të pastrimit, evadimit të mbeturinave urbane në qytetin e Gramshit”, të ndryshuar, të ligjit nr.139/2015, Për vetëqeverisjen vendore, neni 8/2 si dhe neni 54 gërmat “dh” dhe “k”, të tij:

**V E N D O S I**

1. Të miratojë fondet shtesë për dezinfektimin e rrugëve, shesheve, trotuareve, kontenierëve, varrezat publike në bashkinë Gramsh.
2. Të miratojë preventivin për shumën 747 086 lekë/muaj, për një periudhë deri në përfundimin e emergjencës shëndetësore të shkaktuar nga COVID-19.
3. Të lidhet kontrata shtesë me kontraktorin “Kurora” sh.p.k, që do të realizojë procesin e dezinfektimit, në të cilën të përfshihen edhe shpenzimet e kryera deri në datën 26.03.2020
4. Fondet do të përballohen nga buxheti i bashkisë Gramsh për vitin 2020.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen firma sipërmarrëse “Kurora” sh.p.k, kryetari i bashkisë, drejtoria e shërbimeve publike, drejtoria e zhvillimit ekonomik.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Endri MEMA**

Konceptoi : E.Mema  
Miratoi: G.Lena  
Dosja nr. \_\_\_\_\_  
Afati: \_\_\_\_\_



**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Greta LENA**